



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
BAZAT E TË DREJTËS PRIVATE

Ngarkesa: 6 kredite, 25 seminare, 35 leksione

Moduli 1: E drejtë Biznesi

Moduli 2 : E drejtë Administrative

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti I, Sem II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Programi i studimit profesional dyvjeçar në Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-se (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivi i përgjithshëm: T'u ofrojë studentëve njohuri bazë mbi konceptet, parimet dhe terminologjinë juridike të së drejtës së biznesit dhe së drejtës administrative, me fokus në marrëdhëniet juridike tregtare, organizimin dhe funksionimin e administratës publike. Të aftësojë studentët për të kuptuar dhe zbatuar parimet juridike në situata praktike që lidhen me veprimtarinë e institucioneve dhe ndërmarrjeve.

Objektivat specifike

- Të njohin konceptet dhe parimet themelore të së drejtës së biznesit dhe së drejtës administrative, si dhe statusin dhe funksionimin e subjekteve juridike dhe institucioneve administrative.
- Të kuptojnë dhe analizojnë kontratat, detyrimet, pronësinë, marrëdhëniet juridike administrative dhe kompetencat e organeve publike.
- Të zhvillojnë aftësi për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në raste praktike, përfshirë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe njohjen e mekanizmave të kontrollit administrativ dhe gjyqësor.

Rezultatet e pritshme të të nxënit

Në përfundim të dy moduleve, studenti do të jetë në gjendje të shpjegojë dhe përdorë terminologjinë dhe parimet bazë juridike, duke dalluar konceptet kryesore të së drejtës së biznesit dhe së drejtës administrative. Do të jetë në gjendje të analizojë kontrata, marrëdhënie juridike, veprimtari administrative dhe raste praktike, si dhe të identifikojë mënyrat e kontrollit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, do të jetë në gjendje të zbatojë njohuritë juridike në kontekste profesionale, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë dhe procesit të rregullt ligjor.